


BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër

Viti I i botimit, Prill 2008 Nr. 12. Çmimi 20 lekë.

www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



RIKTHIM I FUQISHËM TURQISE NE HAPESIREN SHQIPTARE

Me datën 25 mars 2008, në Shqipëri, erdhi për një vizitë shtetërore kryeministri i Turqisë, z.Taip Rexhep Erdogan i cili zhvilloi takime me përfaqësues të politikës shqiptare, duke filluar nga presidenti Bamir Topi, kryeministri Sali Berisha, kryeparlamentarja Topalli dhe kryetari i opozitës Rama. E rendësishme ishte se së bashku me kryeministrin turk kishte zbarkuar në Shqipëri edhe kupola e biznesit turk që përfaqëson mbi një milion biznese që ka e gjithë Turqia, duke lënë të nënkuptojë, për analizat, se problemet ekonomike do të ishin pjesë shumë e rendësishme e axhendës së kryeministrin turk. Gjatë vizitës njëditore, që zhvilloi delegacioni turk në Shqipëri, u bënë shumë të lexueshme tregues shumë të rendësishëm të hartës që paraqet sot raportet politike, ekonomike, historike dhe kulturore në mes të Turqisë dhe të Shqipërisë. Sidomos, në konferencat e shtypit të të dy kryeministrave, gazetarët dhe përmes tyre opinjoni publik shikuan një qëndrim unik në vlerësimin e lidhjeve historike dhe aktuale në mes të dy popujve. Për kryeministrin Berisha, Shqipërinë e lidhin me Turqinë mijra fije historike në të kaluarën të cilat vazhdojnë edhe sot dhe se Turqia është shteti që i ka qëndruar në të gjitha kohërat

Shqipërisë në mbrojtje. Berisha theksoi se kombi turk dhe kombi shqiptar kanë qeverisë së bashku Perëndorinë Osmanë, duke i dhënë kështu një përgjigje të ashpër historiografisë komuniste të Lindjes, që penalizonte Perëndorinë Osmanë si shpaktare e katastrofave historike të shqiptarve. Në vazhdim të kësaj ideje, ai theksoi se vizita e kryeministrin Erdogan është një zhvillim kulmor në mardhënjat tradicionale në mes të popullit shqiptar dhe atij turk. Ndër-



sa kryeministri turk theksoi se ai po bënte një vizitë në një vend ku ai takon një popull mik dhe vëlla, duke lënë të nënkuptojë kështu se lidhjet e këtyre dy popujve janë një vazhdimësi historike dhe se Turqia e ka mbështetur Shqipërinë në këto 17 vjet pa rezerva duke iu gjëndur pranë edhe në situatat më të rrezikshme për atë. Duke folur para gazetarve, kryeministri Erdogan tha se në strategjinë e politikës së jashtme turke një vend me shumë rendësi zë Ballkani dhe në veçanti Shqipëria, duke u dhënë kështu mediave rastin që të shprehen se Turqia është avokatja më e madhe në arenë ndërkombëtare e Shqipërisë. Ajo që u prit me interesim në fjalën e z. Erdogan para gazetarve, ishte deklarata e tij se Turqia e mbështet dhe është e gatshme të bëjë lobing për të realizuar aspiratën e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në NATO. Ndërsa homologu i tij, Sali Berisha, tha se Shqipëria nuk e kupton plotësisht konfigurativ të BE pa Turqinë dhe se Shqipëria do ta mbështesë Turqinë për të zënë një vend në Këshillin e Sigurimit. Qeveria Shqiptare e faldëroi Turqinë për mbështetjen që

ajo i ka dhënë Kosovës duke e njohur e para Pavarësinë e saj dhe se ishte Turqia ajo që dergoi ambasadorin e pare në Kosovën e Pavarur. Kryeministri turk deklaroi para gazetarve se njohja e Pavarësisë së Kosovës nga Turqia ishte një nevojë e lidhjeve historike, dhe kulturore me Kosovën që është një arsye për shumë të mira në të ardhmen.

Por, pjesa më e rendësishme e vizitës së kryeministrin turk dhe e delegacionit që e shoqëronte kishte të bënte me rritjen e pranisë së biznesit turk në Shqipëri dhe arrijten e parametrave që t'i japin atij sa më shumë hapësirë në ekonominë shqiptare, për ta çuar ekonominë shqiptare në standarta bashkohore Z. Erdogan tha se, kur ai erdhi në pushtet me qeverini e tij, investimet turke ishin 38 milion dollarë, kurse sot ata arrijnë në 620 milion dollarë. Unë sapa erdha në pushtet i kam vënë rendësi të vërtetë rritjes së investimeve në Shqipëri duke e bërë më pas Kryeministrin Berisha të deklarojë se Z, Erdogan është një mik i madh i Shqipërisë dhe i popullit shqiptar. Ne, vazhdoi kryeministri turk, do ta bëjmë Shqipërinë

një vend të rendësishëm ekonomik në Ballkan dhe do të vazhdojmë të forcojmë miqësinë e hershme në mes të dy vendeve. Në të njëjtën linjë ishte edhe kryeministri shqiptar që deklaroi se vitet e fundit qeveria shqiptare ka krijuar një klimë miqësore për biznesin turk dhe lavdëroi kompanitë turke Kurum dhe Calik për investimet e fuqishme të tyre në Shqipëri dhe se z. Erdogan, që me ardhjen e tij në pushtet, i dha një impuls të ri investimeve turke në Shqipëri. Sidomos, premtimi i kryeministrin turk për të kaluar një degëzim në Shqipëri të gazsjellësit që kalon përmes Turqisë, Greqisë dhe Italisë ishte një lajm shumë i rendësishëm për ekonominë shqiptare dhe një gatishmëri konkrete për ta çuar ekonominë shqiptare më përpara. Sot, Turqia, tha z. Erdogan, zë vendin e pare në shkëmbimet tregtare me Shqipërinë dhe se në maj do të nënshkruhet traktati i tregtisë së lire në mes të dy vendeve që do t'i vendosë dy vendet në kushte të barabarta.

Kryeministri turk i kërkoi pales shqiptare që të rishikojë tekstet e historisë, sepse ka gabime, sidomos ato të shekullit të 15, që nënkupton periudhën e Skenderbeut.

Mediat shqiptare edhe kësaj rralle treguan një turkofoni të theksuar e cila u duk tek hapësira e pakët që ata i kanë lënë vizitës së kryeministrin turk duke pasqyruar edhe media që nuk e paraqitën aspak këtë vizitë. Por, ky qëndrim mediave nuk e ulën vlerën e vizitës së z. Erdogan në Shqipëri e cila mbetet një vizitë historike e një miku të madh që përfaqëson një popull mik dhe vëlla i ndodhur gjithmonë pranë shqiptarve në ditët më të mira të tij dhe në ditët më të vështira të tij.

Selim Gokaj

**Antiturqizmi,
maskë e antishqiptarizmit të serbo-rusofilisë**

fq. 2

**Kur laicizmi përdoret si armë
kundër muslimanëve**

fq. 3

**Hasan Riza Pasha
dhe Shkodra**

**Në Shkodër përkujtohet ditëlindja e profetit
Muhamed (a.s.)**

fq. 4

fq. 5

**Botim i ri Islam
që premtion shumë**

**Ministri i punëve të jashtme Lulzim Basha në
konferencën e vendeve islamike**

fq. 5

fq. 6

Antiturqizmi, maskë e antishqiptarizmit të serbo-rusofilisë

Tani vemi re fare mirë se është përsëri acari rus që vërshon drejt Ballkanit si në kohën e luftimeve kundër Perandorisë Osmane që të ngrijë edhe një herë zgjidhjen e çështjes së Kosovës, të çështjes kombëtare shqiptare në tërësi. Këtë ka bërë Rusia Cariste në kohën kur ishin krijuar Pashallëqet e Mëdha shqiptare dhe shqiptarët ishin më afër krijimit të shtetit të tyre, para shteteve serbe e greke në Ballkan. Këtë ngrijje solli Rusia për çështjen shqiptare edhe në kohën e "Kongresit të Berlinit", kur duhej njohur kombi shqiptar në Europë dhe duheshin bashkuar në një të katër vilajetet shqiptare, në rrethanat e dobësimi të Perandorisë Osmane. Të njëjtin gjë bëri Rusia kur duhej njohur shteti i pavarur kombëtar shqiptar në vitet 1912-13, kur duhej zbatuar parimi i vetëvendosjes së popujve edhe për shqiptarët në Ballkan pas LDB. Të njëjtin gjë kërkoi të bëjë edhe së fundmi, në kohën kur duhej njohur pavarësia e shtetit sovran shqiptar të Kosovës.

Më 9, 10 dhe 11 Janar 2008 në gazetën "Republika" është botuar studimi i Pr. Eshref Ymerit mbi politikën e veprimtarinë e tërbuar armiqësore shumëshekullore të armikes së betuar të shqiptarëve, Rosisë. Analiza që bëhet në këtë studim i jep lexuesit e opinionit publik shqiptar (madje dhe politikanëve e intelektualëve që dëshirojnë) një udhërrëfyes publicistik për të kuptuar edhe më mirë materialin e gjërë faktik që përmban libri i Shaqir Vukajt "Kosova dhe Rusia". Kurse shkrime si ai i Engjël Koliqit, ai i Gjetë Kolës dhe i disa të tjerëve janë në frymë e kahje krejt të kundërt, shkojnë në vazhden e rrymës që njihet prej kohës si serbo-rusofili. Këta shkrime duken të ndikuar nga demagogjia e Beogradit dhe e Moskës, posaçërisht nga intervista e ambasadorit të Rosisë në Tiranë, zotëri Prishpoviti, botuar në gazetën "Shqip" më 23 Dhjetor 2006, në të cilën jepej si verdikt i prerë se nuk mund të ketë zgjidhje tjetër për Kosovën veç asaj që do të pëlqejë edhe Beogradi dhe qeshja e Kosovës nuk duhet lidhur me marrëdhëniet e Rosisë e të Shqipërisë, pasi këto marrëdhënie duhet të vështrohen vetëm në prizmin e "miqësisë së popujve".

Nuk ka si të mos bjerë në sy për keq kur dhe autorë shumë të pranishëm në botimet e në publicistikën shqiptare, me studime e shkrime që shpesh kanë mjaft peshë, si Pr. Hulusi Hako, që shpalohej mëndime për patriotizmin që duhet të kenë shqiptarët, pikërisht në këtë kohë e gjen me vend të dërdhë nostalgjitë e tij për kohën e shkuar si student në Rusi, madje të kapërcëjë masën duke shpërfaqur e reklamuar me krenari rusofilinë e tij. Në pjesën e serialit nostalgjik "Ditari i Moskës" të cilën autori e përmend dhe me termat "Moska ime" të botuar më 13 Dhjetor 2007 në "Telegraf" autori ka shkruar: "U mbushën plot 50 vjet që kur jam ndarë nga Moskë! Nostalgjia veçse është shtuar... kujtimet e atyre viteve nuk janë thjesht një moment përjetimësh turistike... por u bënë vizioni më dimensional për të qenë i dobishëm për Atdheun tim".

Nuk do t'i jepja vetes të drejtën të shprehesh pa për këto ndjesi të autorit, po të mbeteshin ato thjesht vetanake të

tij, edhe pse unë si ish-student në Rusi, në Moskë, në Institutin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (Diplomacisë) nuk kam përjetuar kurrë ndjesi të ngjashme dhe nuk kam asnjë nostalgji për ato dy vitet që kalova atje midis rusëve, ndonjëse kam kujtime të mira nga shkolla, nga bashkëstudentët. Por autori i "Ditarit të Moskës" ka shkuar më tej, ka hyrë në terren me interes publik, ku na takon të gjithëve të ngulim belin e lopatën për të shkullur barërat e këqija dhe për të kultivuar bimësi shqiptare; ka hyrë në terrenin e vlerësimit politiko-diplomatik të marrëdhënieve shqiptaro-ruse, madje me një qasje që përputhet shumë me intervistën e para një viti të ambasadorit rus në Tiranë.

Unë kam reaguar ndaj asaj interviste të ambasadorit rus nëpërmjet një "kartoline të hapur" për vitin e ri, sepse dhe intervista ishte si një mesazh drejtuar shqiptarëve në vigjilje të vitit të ri 2007. Shkrimi "S novim godom-gëzuar vitin e ri" është botuar në "Rimëkëmbja" më 26 Dhjetor 2006. Në mënyrë të veçantë theksoja se është e natyrshme dhe e domosdoshme për shqiptarët (pavarësisht si mendojnë e veprojnë pushtetarët e tyre) që në vartësi të qëndrimit të Rosisë për çështjen e Kosovës shqiptarët të ndërtojnë marrëdhënieve ruso-shqiptare. Këto marrëdhënie duhen parë siç janë në realitet, si marrëdhënie midis shteteve e qeverive dhe jo sipas tezës së rreme demagogjike sovjetiko-komuniste për "miqësinë e popujve", që na e kishin trumbetuar deri në mëzë në vitet e shkollimit në Moskë dhe që në fakt asnjëherë nuk ka gjetur zbatim konkret për shqiptarët, kur bënin miqësi të mëdha me jugosllavët, rusët, kinezët, apo kur themi të njëjtin gjë me grekët tani. Mund të themi se vetëm marrëdhëniet me Turqinë kanë në bazë të tyre edhe miqësi popujsh. Por disa janë të prirur t'i trajtojnë si armiqësore pikërisht këto marrëdhënie.

Prof. Hako ka shkruar: "Kanë hyrë në pasurinë time edhe rusofonia edhe rusofilia". Kuptohet se rusofonia ka hyrë në pasurinë e të gjithë shqiptarëve që kanë studiuar në Rusi, apo që mësuan gjuhën ruse në Shqipëri. Kurse me rusofilinë puna qëndron krejt ndryshe. Ajo nuk duhet të hyjë tek asnjë shqiptar, qoftë dhe tek ata që kanë studiuar në Rusi dhe nuk nxjerrin dot nga vetja nostalgjitë për atë vend. Rusofonia dhe rusofilia janë e duhen trajtuar si dy gjëra të ndryshme. Rusofonia është thjesht fakt jete. Rusofilia është ndjesi, madje politike e mirëfilltë e vetëdijshme. "Filltë politike" kanë implikime politike për individin dhe shoqërinë e vendin që i përket individi. Këtë e di dhe profesori që ka shkruar "Ditari e Moskës" me nostalgji, sepse është munduar që ta përligjë rusofilinë e tij me një argument të shpëlarë fund e krye demagogjik: "Se Putinët venë e shkojnë, pavarësinë e Kosovës shqiptarët do ta gëzojnë, por dashurinë e veçantë të popullit rus për ne, edhe ndihmesat as i harrojmë, as i ngatërrojmë me putinarinë e llavrovshërënë! Se tek logjika e hekurit e jetës, dërtësia dhe dashuria e popujve dhe e njerëzve të thjeshtë në fund të fundit do të thejnjë turinjtë gjithë politikët e vogla dashakeqe në qoftë se njerëzimi do të hyjë vërtetë në erën e demokracisë".

Ndaj mendimeve të tilla nuk mund të qëndroja pa reaguar për dy arsye: 1-Për arsyen e përmendur më lart se jam bërë palë, qysh në Dhjetor të vitit 2006, në debatin se a mund dhe a duhet të vështrohen marrëdhëniet shqiptaro-ruse së pari e kryesisht nga këndvështrimi i "miqësisë së popujve" 2- Për arsyen parimore e politike se nuk pajtohem dot me prirjet që midis shqiptarëve të kultivohet rusofilia në kohën kur Rusia dhe rusët po bëjnë një veprimtari tejet armiqësore ndaj shqiptarëve (siç e kanë vërtetuar kohët fundit edhe Shaqir Vukaj me libër prej qindra faqesh dhe Eshref Ymeri me një shkrim të kondensuar publicistik).

Mund të shtoj dhe një shkas të tretë për këtë reagim: zotëri Hako si Kryetar i Shoqatës Atdhetare për Identitet dhe Bashkim Kombëtar ka marrë fjalën përshëndetëse dhe ka përgëzuar "manifestimin madhështor... Vlorë Heroike valëvit flamurin e Pavarësisë së Kosovës", ku ndër të tjera, (sipas gazetës "Ndryshe" të datës 13 Dhjetor 2007) ka thënë: "Ka ardhur koha të rimarrim atë që na përket, zemrën e shpirtin tonë Kosovën, sepse ndryshe trupi nuk ka jetë. Europa është e jona dhe ne jemi Europa". Kjo është thënie e bukur. Por nuk kemi si të mos vëmë re një kontradiktë të madhe ideore dhe politike. Rusia, jo vetëm politikanët, por edhe opinionin publik rus janë kundër bashkimit të shqiptarëve. Kurse zotëri Hako pretendon se identiteti shqiptar dhe bashkimi kombëtar shqiptar mund t'u bëkan duke kultivuar, ushqyer e reklamuar rusofilinë midis shqiptarëve. Kjo nuk shkon, ose njëra, ose tjetra. Rusofilia nuk të ndihmon të ruash identitetin e të bësh bashkimin kombëtar shqiptar, por të tërheq drejt një qëndrimi kobtar për këtë identitet e këtë bashkim. Kush të dojë le ta besojë, kush të dojë të mos besojë, por unë kam bindjen se faktet që i kemi ditur dhe ato që kanë renditur tani vonë Vukaj dhe Ymeri këtë na mësojnë.

Ai arsyetimi se Putinët e Llavrovët vinë e shkojnë që e ka bërë Hako si argumentin kryesor për të besuar tek miqësia e popujve shqiptaro-ruse nuk i ujë fare, sepse kjo miqësi nuk ka ekzistuar ndonjë herë dhe as që mund të krijohet përdrejtë gjithë sundesit, politikanët, qeveritarët, intelektualët e Rosisë në opinionin publik, tek njerëzit e thjeshtë rusë, kanë përçuar e përçojnë vetëm shovinizëm, përzbuzje, mllafe e urrejtje për shqiptarët.

Është e vërtetë se Jelcinët, Putinët, Ivanovët, Llavrovët, Medvedievët do të shkojnë e të vinë në Rusi, siç kanë ardhur e kanë shkuar në shekuj carë, bojarë, gjeneralë, admiralë, hierarkë komunistë. Por këtu qëndron dhe keqja më e madhe se gjithmonë, të paktën gjatë 3 shekujve të fundit, në drejtimin e Rosisë e të rusve kanë ardhur pa anjë përjashtim komandues e drejtues që ndaj shqiptarëve kanë treguar vetëm armiqësi. Kështu ka ndodhur edhe kur Carë të Rosisë ishin burra, edhe kur ishin gra; edhe kur në krye të Rosisë ishte një careshë gjermane (Jekaterina II) edhe kur padron i Kremlinin bëhej një gjeorgjian (Josif Stalini); edhe kur ministri i jashtëm quhej Sazonov, Litvinov, Molotov edhe kur quhej Shevarnaxe (gjeorgjian); edhe kur poste të tjera me rëndësi i mbanin rusë, edhe kur titullarët e ndihmësit kryesorë ishin

qifutë, armenë, gjeorgjianë, polakë, balltikas, dikur më herët dhe ndonjë arvanitas nga Greqia (Kapodistria).

Ajo "miqësia e popujve" që do të frymëzoka një ditë rusët ndaj shqiptarëve do të vijë për "Bajramin rus" (kalendat greke) që e përmend Eshref Ymeri dhe që vetë Hulusi Hako e ka bërë me një ekuivalent kushtëzues shqiptar "në qoftë se njerëzimi do të hyjë në rrugën e demokracisë". Kurse populli e ka thënë me kohë më thjeshtë "prit gomar të mbijë bar", që duhet kuptuar në këtë rast "prit shqiptar sa të ngrenë rusët kopshtin e miqësisë për ty".

Po ç'e do se rusët vazhdojnë të edukohen më shumë me Tolstoin, i cili ngushëllimin e heroit të tij të dhëmbshur, Vronskit (në romanin Ana Karenina), e ka lidhur me nisjen e tij "heroike" për të ndihmuar serbët në luftën kundër osmanëve. Shumë rusë në vitin 1999, siç dëshmon Shaqir Vukaj, ndiqnin shembullin e Vronskit, regjistroheshin vullnetarë për të masakruar bashkë me serbët shqiptarët në Kosovë. Është mirë që "Vlorë heroike e ka valëvitur flamurin e pavarësisë së Kosovës" në dhjetor 2007, se kështu bëhet një hap për të shlyer kujtimet e këqija që na kanë mbetur nga tundja e tre gishtave serbë në Sheshin e Flamurit në Vlorë në pranverën e vitit 1997, kur serbët kishin nisur valën e madhe të gjencidit në Kosovën. Do të bënin mirë edhe nostalgjikët për Rusinë që ta flakin rusofilinë dhe të mbeteshin tek shqiptarizmi.

Do të bënin mirë t'u largoheshin marrëzisë ata shqiptarë që pa pushim mallkojnë e fajsojnë Perandorinë Osmane për gjithë vështirësitë që provojnë shqiptarët brenda trojeve e shoqërive të tyre dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare edhe 100 vjet pas shpërbërjes së saj. Me (allogjikën e tyre të quditëshme njerëz të tillë ka të ngjarë të fajsojnë ndonjë ditë Sulltanin edhe për aksidentet e rëndë që ndodhin në furrallatet e shfrytëzuar nga kompania turke "Kurum" në kombinatin metalurgjik kinezo-shqiptar në Elbasan.

Antiturqizmi sado të mbështetet me propagandë nuk maskon dot armiqësinë serbo-ruse ndaj shqiptarëve, as e përligj rusofilinë e serbofilinë midis shqiptarëve. Cilatdo të kenë qenë marrëdhëniet shqiptaro-osmane në kohën e Perandorisë 600-vjeçare të Sulltanëve, Turqia e re, që nisi jetën si shtet kombëtar në vitet 1920, doli si mike e madhe e shqiptarëve dhe e Shqipërisë. Duan apo nuk duan disa shqiptarë të trullosh nga antiosmanizmi e antimuslimanizmi, Turqia e re dhe kombi i sotëm turk e kanë dëshmuar veten si miqtë më të sinqertë të shqiptarëve gjatë gjithë kohës. Edhe sot Turqia është i vetmi vend që dyert i saj i mban të hapura me dashmieri për shqiptarët, i vetmi vend ku po të thuash se je shqiptar (arnaut) rrethohesh menjëherë me kujdes e dashuri, i vetmi shtet që nuk mendon si të izolojë shqiptarët e zakonshëm në botë. Dhe pikërisht në këtë vend duan t'i armiqësojnë shqiptarët njerëzit që u japin "këshilla Djalli" në shkrime si ai mbi "bortexhet historike të Turqisë ndaj Kosovës". Pikërisht këtij shteti e kombi i dërgojnë herë pas here mesazhe provokuese disa shqiptarë që duan të njollosin në sytë e turqëve gjithë shqiptarët e tjerë si "mos-mirënjohës" ndaj mikut, që të kënaqen hasmit e shqiptarëve.

Kur laicizmi përdoret si armë kundër muslimanëve

Laicizmi duket se po shndërrohet në gjetjen e fundit në gjuetinë e shtrigave. Ndoshta edhe dekreti qeveritare për vendosjen e rregulloreve të brendshme që përcaktojnë uniformën bashkohet me qëllimin mesjetar.

Përdoruesit e termit injorojnë universalizmin e tij dhe realitetin shqiptar.

Përfillet shumë për laicizem të sanksionuar nga rregullorja e shkollës, në rastin kokret, apo të kushtetutes kur ai merr përmasa me të gjera. Neni " 7 " laq i lakuar është i qarte: "Në shkollë nuk lejohet propaganda fetare". Por a është mbulesa propagande fetar? Muslimanija e ka detyrim të mbulohet të përcaktuar në Librin e All-Ilahut dhe në traditën Profetike. Duke qene se obligimi në veshje është praktikë ashtu siç janë edhe praktikë të tjera si namazi, agjerimi etj, propaganda nuk gjën vend ketu. Te frekuentosh objektet e kultit dhe të adhurorsh Krijuesin jo vetëm në Islam por edhe në besime të tjera është pjesë e ushqimit shpirtërore, modelit të jetes që individit zgjedh, identitetit të cilit i kushtohen sakrificat, zbatim i praktikave dalluese fetare dhe jo propagande. Nëse një urdherese fetare shkeputet nga praktikë fetare kjo duhet të ndodhë me të gjitha praktikat e tjera të siperpërmendura dhe në të gjitha besimet jo vetëm në ate Islam. Mbulesa, namazi dhe obligime të tjera identifikojnë muslimanin. Ndalese e një praktikë fetare automatikisht shkel të drejtën e individit të sanksionuar jo vetëm me Kushtetutën tone por edhe me Kartën e të Drejtave të Njërit të OKB-se.

Shembulli i Frances kaq i përfolur kundershohet nga të gjitha vendet e tjera Perëndimore që e tolerojnë fenomenin "mbulesë" në shkollë publike.

Edhe pse (vetëm) Franca e ndalon në nuk jemi në kushtet socio-kulturore dhe politike franceze. Ndersa atje Islami përben 10% të popullsisë, në trojet shqiptare kjo përqindje (10%) është pak më e vogël e shumta e të gjitha feve të tjera tradicionale. Tradita Islame e trojeve shqiptare është shekullore, identiteti i popullsisë është Islam për më tepër nuk përjetojmë problemet e impaktit fetar nga integrimi i muslimanëve, tashmë pjesë e realitetit shqiptar shekullore, siç ndodh në modelin integralist francez. Keto sebashku me tradicionalizmin fetar-kulturore të mbulesës si pjesë e trashëgimisë sone mijëra vjeçare e përfaqësuar nga veshjet kombëtare që paraqesin femrën tone të mbuluar (historikisht nën ndikimin apo jo të fese) nga të gjitha besimet, rasti Nene Tereza apo femrat muslimane në rastin konkret, si dhe tolerancën e një praktikë të tillë në Perëndim i bën qesharake përpjekjet e pseudolaikeve tane.

Vendet publike nuk janë vetëm shkollat 9 vjeçare por edhe spitali, ambiente qeveritare, bashkia me të gjitha ambientet e sajë, zyra e politikantit, aeroporti, porti, teatri, uni-

versiteti, rruga, sheshi, lulishta, shkolla e pallatit, treni, mediat shtetërore etj. Kjo do përjashtonte keto vaji nga të gjitha ambientet e siperpërmendura. Pra të mos kemi asnjë femer muslimane që aplikon besimin e saj ashtu siç kërkohet as në rrugë, sheshë, spitale dhe në asnjë hapërisë publike. Mire në shkollë paskeka uniforme po në ambientet e siperpërmendura cafer rregullash përcaktuese ka? C'vlere ka ketu sanksionimi me kushtetute të lirive fetare nëse ato reduktohen vetëm në shtëpi? Une nuk kam nevojë që kushtetuta të sanksionojë veshjen në shtëpi time por të mbrojtë liritë e mia në ato ambiente të cilat unë ja kam deleguar shtetit që t'i administrojë dhe ligjerë.

Për të parë një shembull konkret ftoj të drejtën veshtrimit në qytetet italiane ku do të gjëni se në shkollat publike (që do të thotë ndër të tjera, shkollë me frekuecë të lirë) nuk ekzistojnë rregulloret të tilla absurde. Rregullorja përcaktohet nga kolektivi akademik, përfaqësues të nxenesve dhe prindërve. Keshtu ndodh në Italinë përndimore. Tek në siç duket përcakton drejtorja apo vetëm keshilli i mesuesve. Mbi cilat kritere? A merren para sysh se shkolla ka praktikante? Nëse jo atëherë a nuk është ky diskriminim?! Nëse në Perëndim kjo praktikë fetare është e lejuar, pra rregulloret nuk e ndalojnë, në duhet të jemi me laik se ai komunitet (BE-ja) në të cilin pretendojmë të behemi pjesë?!

Italia është vend laik i përcaktuar në Kushtetute por kjo nuk pengon që në ambiente publike të shikojmë kryqin, të gjejmë kisha neper spitale dhe stacione treni shtetërore, zhvidhimin e një ore fetare kristjane në shkollë si pjesë e programit mesimor. Britania e Madhe është vend laik por Mbreti vesh edhe rolin e Guvernatorit të Suprem të Kishës Anglikane, ipeshkvet kanë vendin e tyre në Dhomen e Lorëve. SHBA janë shtet laik sipas Kushtetutes por Presidenti që në kohën e Presidentit Eisenhower zhvidhohet "Lutja e Mengjezit" në ambientet e Shtëpisë së Bardhë.

Në Shkodër një figure e lartë në hierarkinë kishtare vizitonte shkollat publike dhe në njerën prej tyre u prit me recitime Biblike dhe vjersha me karakter fetar, sigurisht jo për praktikë fetare apo simbollogji. Paralel me përjashtimin dhe hysterinë laike që pasoi rastin e dy motrave në Tiranë, në Shkodër në një shkollë publike 9 vjeçare janë shpërndarë fletushka me karakter fetar jo-islam. Kjo nuk bën pjesë tek simbollogjia e aq më tepër tek praktikë fetare por është pjesë e propagandës të ndaluar pikerisht nga ajo kushtetute kaq shumë e përfolur. Cështja i ka kaluar organeve hetimore. Femija, debatikus nuk është përjashtuar. Si për rastin e parë ashtu edhe për të dytin nu sfida të gjëni një gazetë, media elektronike që e t'i ketë cituar. Viktimat e Gerdecit ndonëse muslimane, në tentativën për kujtimorë të ndermarrë nga opozita që duhet të jete laike, u përcollën në heshtje me qirinje, pra me një ritual kristjan !!



Platforma e laicizmit duhet të jete e qarte, përndryshe ka vetëm njëanshmëri që synojnë çungimin e aplikimit të fese, në rastin konkret asaj Islame.

Anashkalimi i simbollogjive në besimet të tjera ndonëse nuk janë as praktikë shndërrohet në deshmë të kesaj njëanshmërie. Nxenesit, bota e spektaklit, politikanet, mesuesit, njerezit e thjeshtë prezantohen në ambiente publike me simbollogji joislame, në mbushin televizionin shtetërore dhe askush nuk shkruan një resht të vetëm, nuk ka asnjë analist apo emision televiziv që i trajton si shkelje të kushtetutes dhe propagandues.

Shteti ynë mbushi të gjitha qytetet me buste dhe emertime sheshesh, rrugesh e institucionesh të tjera publike që përfaqësojnë figura të mirefillta fetare si Nene Tereza, Bogdani që e kaluan jetën në shërbim të fese. Një vajzë muslimane duhet të përjashtohet nga një institucion publik por genka normale kur ky institucion mban emrin e një murgeshë?! Kodrat e Bushatit ku u mbollën simbollet, pra jo praktikë fetare, që të demonstruara në kete mënyrë marrin vetëm vlera propagandistike, kodra dhe male të tjere që ndoqen të njëjtin fat janë edhe ato, të nderuar pseudolaike, pjesë e shtetit tone madje pasuri e të gjithë kombit. Apo në keto raste kushtetuta nuk vlen?! Unë arrij në aeroportin e Rinanit dhe shikoj një kryq me formën e një shenjetoreje katolike apo një shenjetore në formën e një kryqi. Meqenëse laicizmi genka kriteri i shtetit, mediave dhe i disa bashkëatdhetarëve të mi, duhet të mendojë se aeroporti duke bartur një figurë dhe emer shenjetoreje pra duke u fetarizuar, nuk është me publik pra është privatizuar. Po keshtu edhe kodrat e malet në të cilat mbijne kepurdat fetare. Jo vetëm ato, por edhe zyrrat e Presi-

dentit, Kryeministrit të Shqipërisë apo homologeve të Kosovës e Maqedonisë që mbjane figura fetare madje me "ferexhe" si Nene Tereza ose nuk janë me publike, si shkelje të laicizmit, ose laicizmi është vetëm kundër Islamit. Kujtoj të ndjerrin Rugova që teksa i bente publicitet pasivizmit dhe viktimizmit të tij prezantohet mes Nene Terezës dhe Gjon Palit II. Ketu ose Rugova nuk njihje laicizmin ose institucioni që përfaqësojnë ishte fetare!

Në po kërenohemi dhe po mbjellim atdheun me një murgeshë me mbulesë por kur bartesja është muslimane përdoret mburoja e laicizmit.

Laicizmi nuk lindi për të kundërshtuar vetëm një fe madje nuk lindi as si vaksine kundër Islamit. Ai u ngrit në nivelin e një feje pa zot për të ndare pushtetin politik nga ai fetarë i krishtere European në shekullin e Iluminizmit. Në vazhdojmë të jemi vend i cudirave. E them kete sepse nuk është e para here që përballemi me fenomenin e mbulesës Islame dhe nuk është e para here që praktikë Islame barazohen me propagandë ndersa propaganda antikushetuese dhe antikombetare shndërrohet në normalitet apo praktikë fetare. Ky laicizem shurdhohet dhe verbohët përballë "ferexhese se Nene Terezës" dhe simbollogjisë fetare të figures se sajë apo të simboleve të tjera fetare që vendosen në të gjithë territorin shqiptar.

Modeli është i qarte, të fetarizohen sferat publike me emertime, simbole dhe buste figurash joislame por të ndalohet frekuentimi i tyre nga besimtarët muslimane.

A është ky shteti i shqiptarëve ??

Doan DANI

HASAN RIZA PASHA DHE SHKODRA

Prof. Dr. Gazmend Shpuza

Historiografia shqiptare ka vënë në dukje, sipas saj, rolin vendimtar që luajti faktori shqiptar në mbrojtjen e qytetit të Shkodrës nga forcat malazeze dhe ka sqaruar prej kohësh rendësinë që pati kjo luftë dhe pasojat që pati rinia e saj nga pushtuesit malazezë gjatë debateve për caktimin e kufijve veriorë të shtetit shqiptar Kohet e fundit, autorë shqiptarë kanë dhënë më mire peshën dhe rolin që luajti garnizoni osman dhe në mënyrë të veçantë valiu dhe komandanti turk, Hasan Riza Pasha. Po evidentohet këndvështrimi realist që ai pati për gjëndjen dhe zhvillimet ushtarake në pjesën perëndimore të Perëndorisë Osmane në prag, sidomos pas fillimit të Luftës së Parë Botërore. Në këtë kuadër ai vlerësoi realisht shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe mori qëndrimet përkatëse që qenë shumë realiste për momentin Si komandan me vision të qartë, jo vetëm ushtarak, por edhe politik, ai arriti të kapërcejte hendeqet nga politika e gabuar e xhonturqve, kur ata erdhën në pushtet. Mbi baza të ndërsjellta, u realizua aleanca luftarake shqiptaroturke në krye të cilës ishte për turqit komandanti, Hasan Riza Pasha dhe për palën shqiptare, kryetari i bashkisë së Shkodrës, Muharrem Gjylbegu. Mbrojtësi i Shkodrës u dëshmyua me qëndrimin e tij, jo vetëm si një strateg i shquar, por edhe një komandant trim.. Qëndrimi për pak kohë promalazez i malsorëve të Mbishkodrës, kryesisht katolikë dhe qëndrimi konsequent gjatë luftës Ballkanike proosman i mjaft personaliteteve të lëvizjes kombëtare antiosmane, qofshin edhe të krishterë edhe klerikë si: Fan Noli e Gjergj Fisha, flet për vlerësimin e drejtë të tyre për rrezikun vdekjeprurës të agresionit ballkanik ndaj tokave shqiptare. Ky qëndrim nuk mund të shpjegohet dhe

të motivohet nga studjues dhe historianë të ndryshëm më frymën orientale të veprimtarve shqiptarë që e paska lënë Shqipërinë jashtë rolit dhe pjesëmarrjes së saj në Luftërat Ballkanike. Marrëveshja në mes të Hasan Riza Pashës dhe atdhetarve shkodranë për ngritjen e flamurit në kala, krahas atij turk, u sabotua me vrasjen e pabesë të Hasan Riza Pashës nga Esat Pasha.. Të gjitha rrethanat, si përsa i përket vendosmërisë së garnizonit turk dhe qytetarve të Shkodrës, raportit real të forcave ushtarake në front, qoftë edhe ato pak rezerva të mbetura ushqimore, nuk e përligjin aktin kapitullues të Esat Pashës për t'u dorëzuar Shkodrën malazezeve.

Nga të gjithë tashmë dihet se çfarë pasojash pati në caktimin e kufijve veriorë të shtetit shqiptar tradhëtia e Esat Pashës. Lufta e aleatëve ballkanikë në mbrendësi të trojeve shqiptare nuk ishte një luftë për të evropjanizuar Ballkanin, por synonte deorjentalizimin e tij Lufta e padrejtë pushtuese e Malit të Zi ndaj Shkodrës nuk mund të quhet e drejtë në emër të qëndrimeve euroatlantike, duke menduar se në këtë mënyrë mund të zhduken mendimet orientale, duke përligjur politikën aneksuese dhe shoviste të fqinjëve tanë ballkanikë ndaj vendit tone. Të cilat nga ana tjetër do ta gjakosin Ballkanin deri në shekullin e 20 me masakrat që u bënë në ish- Jugosllavi.. Lufta për mbrojtjen e Shkodrës do të mbetet një nga faqet më të ndritura të atdhetarizmit shqiptar dhe të vendosmërisë së popullit shqiptar për mbrojtjen e trojeve të Atdheut. Kjo luftë e viteve 1912-1913, në mbrojtje të qytetit të Shkodrës, do të mbetet gjithashtu një dëshmi e bashkëpunimit ushtarak në mes të popullit shqiptar dhe atij turk, bashkëpunim që është prezent edhe në ditët e sotme, kur një repart ushtarak shqiptar

është i inkuadruar në komandën e trupave turke në Afganistan. Qëndrimin pozitiv ndaj zhvillimeve në Shqipëri në ato momente, komandanti turk e shprehu qartë, kur e kuptoi se në këto momente historike interesat në mes të shqiptarëve, që ishin ndarë, tashti duheshin të bashkoheshin përballë një armiku të përbashkët që ishte shovinizmi malazes ndaj trojeve shqiptare.. Duke pasqyruar parasysh realitetet e reja, komandanti trim turk nuk interesohej vetëm për fatin e garnizonit turk, që kishte në komandë, sepse këtë mund ta kishte bërë lehtë duke u




marrë vesh me forcat malazeze. Në një letërkëmbim me deputetin e Dibrës në Parlamentin xhonturk, Basri bej Dukagjini, ai është dakort që të sigurohen rrugët për të shpëtuar Shqipërinë. Për Hasan Riza Pashën, mbrojtja e Shkodrës kishte të bënte me çështjen e zgjidhjes së çështjeve shqiptare në mbështetje të vendimeve të Kuvendit të Vlorës dhe të njohjes së autonomisë së Shqipërisë nga Konferenca e Londrës. Komandan-

ti i garnizonit turk i kishte kërkuar Gjergj Fishtës të shkruante një marsh për ushtarët shqiptarë, në shumicë muslimane, që ata ta këndonin këtë marsh në gjuhën shqipe në stërvitje dhe beteja luftarake. Eshtë po ky Hasan Riza Pasha që do t'i kërkojë komandantit të armatës Perëndimore Osmane, Mahmut Hajret Pasha, që me forcat e tij ushtarake të angazhojë kundër forcave serbe që po marshonin drejt Shkodrës, thirrje që ai ia bën këtij komandanti në emër të shqiptarizmit dhe të osmanizmit. Angazhimin e Hasan Riza Pashës në mbrojtje të shqiptarizmit e ka kënduar edhe poeti popullor Sipas këngës popullore, Hasan Riza Pasha kishte menduar që të vihej në shërbim të kësaj toke për ta shpëtuar këtë komb dhe se rruga e vetme për të shpëtuar Shkodrën ishte "Ta çojmë bajrakun" dhe se komandanti trim turk flamurin shqiptar e kishte bërë edhe flamurin e tij. Forcat për mbrojtjen e Shkodrës ishin të ndara në dy pjesë. Në njërin ishte Hasan Riza Pasha me garnizonin e tij dhe luftëtarët shqiptarë të cilët ishin nën komandën e Valiut të Shkodrës. Interesant është fakti se këngët kushtar mbrojtjes së Shkodrës kanë një shtrirje deri në çamëri, të cilat e përshkruajnë me simpati koma-

ndantin turk duke e paraqitur si hero legjendar që martirizohet për Shqipërinë. Kur u shtrua çështja e kandidatures së një princi të Shqipërisë që sapo u njoh ndër kombëtarisht, kleri katolik parapëlqente një princ musliman që ishte Hasan Riza Pasha. Në vitin 1936, eshtrat e Hasan Riza Pashës u çuan në varrezat e Komaneve. Gjergj Fishta do ta vlerësonte komandantin e famshëm turk duke thenë se Hasan Riza Pasha do të kujtohet si atdhetari ma i mire për shpëtimin tone nga kthetrat e malazezeve dhe se ai meriton të lavdërohet baraz me heronjtë e kombit shqiptar dhe se ai kishte qenë mik i shqiptarve dhe i Shqipërisë. Kurse Zejnel Prodanin, kryetari i Bashkisë së Shkodrës do të deklarojë se populli i Shkodrës nuk e harron kurrë..... Edit Durhani do ta vlerësojë duke thenë se një gjë është e vërtetë. Hasan Riza Pasha ishte një ushtar i shkëlqyer, sepse ai e shpëtoi Shkodrën me planin e tij ushtarak

Mund të thuhet me të drejtë se mbrojtja shqiptaroturke e Shkodrës në vitet 1912-1913 u kurseu popujve të Ballkanit një luftë të katërt ballkanike dhe banorëve të Shqipërisë veriperëndimore gati një shekull shtypjeje nga një genocid fetar-etnik të cilin e përsuan shqiptarët e viseve të tjera veriperëndimore, lindore dhe jugore. Sot, në Shkodër lartësohet një memorial madhështor para prefekturës së qytetit në shenjë nderimi për këtë mik të shqiptarve dhe të Shqipërisë sepse ai ka mbetur një urë solide për lidhjet e hershme dhe në vazhdim në mes të popullit shqiptar dhe atij turk, të cilët paten bashkëqeverisur Perëndorinë e Famshme Osmane.



NE SHKODËR PERKUJTOHET DITËLINDJA E PROFETIT MUHAMED (A.S)

Eshtë përkujtuar në qytetin e Shkodrës, me datën 19 .3. 2008 ,ditëlindja e profetit ,Muhamedit a.s. në një ceremoni të organizuar nga Myftina Shkodër e cila u organizua në xhaminë më të madhe të qytetit , „Ebu Bekër. Megjithëse xhamia është në rikonstruksion , ky aktivitet u ndoq nga një numur shumë i madh besimtarësh muslimanë dhe besimtare muslimane të cilët ishin të organizuar që këtë aktivitet ta shihnin në dy orare të ndryshme që mendojmë se janë të lidhura me idenë e mbarëvajtjes së këtij aktiviteti i cili është bërë traditë ,sidomos pas rihapjes së fesë në Shqipëri ku aktiviteti për ditëlindjen e Profetit Muhamed ka marrë përmasa më të mëdha si në cilësinë e organizimit ,ashtu edhe në masën më të madhe të besimtarëve që i shoqërojnë këto aktivitete Në aktivitetin e sivjetshëm theksi duket se ishte vënë tek aktiviteti i motrave muslimane, ku merrnin pjesë myftiu i Shkodrës, imam Ndrëçim Sulejmani ,drejtuesi i i arsmimit dhe kulturës pranë myftinisë Shkodër, Arben Halluni si edhe imamë nga xhamitë e qytetit dhe të ftuar

të tjerë që ishin thirrë nga muftinia Shkodër, për të marrë pjesë në këtë ceremoni.Aktiviteti filloi me leximin e disa ajeteve kur-anore nga Hafiz, Shukri Kapllan, kurse hapjen e kësaj ceremonie e bëri teologu Arben Hallun.


Në vijim të aktivitetit, myftiu i Shkodrës ,imam Ndrëçim Sulejmani, mbahti një kumtesë e cila kishte të bënte me jetën dhe vepren e Profetit ,Muhamedit a. s.Pjesë me shumë rëndësi e këtij aktiviteti ishte edhe programi artistik që ishte përgaditur nga grupi artistik i medrezesë ,dega e vajzave i cili u paraqit me një përgaditje cilësore.Në programin e këtij grupi, u kënduan pjesë nga Kur-ani Sherif, salavate dhe u recituan poezi me përmbajtje fetare islame.Kjo veprimtari e larmishme fetare kushtuar ditëlindjes së Profetit ,Muhamedit a.s., u mbyllme një dua hatme ,duke lënë pas dëshirën e madhe që muslimanët të takohen gjithmonë sa më shume për aktivitete të tilla madhështore.

Kronisti Shkodër, me 19 mars 2008

NJE BOTIM I RI ISLAM QE PREMTON SHUME

Vitrinës së librit islam iu shtua dhe një botim i ri i cili, për nga përmbajtja dhe nga penda që e shkroi, është krejt i vaçantë ,sepse lexuesi do të shohë që mendimet dhe idetë të cilat ai takon duke e shfletuar këtë botim janë dhënë thjesht pa i ulur vlerën e mesazheve që ai përcjell për atë që ka vendosur ta bëjë të tijin librin Fjalë Frymëzuese dhe me atë të pasurojë edhe bibliotekën e tij .

Ndërsa për autorin e tij, e veçanta është se ai ka vendosur të hapë një dritare të re në fushën e letrave e cila bëhet edhe më e rëndësishme, sepse ai po hap dritare në fushën e letrave islame duke u prezantuar si një pendë e re dhe, pasi e lexon njeriu librin, e kupton autori Mirsad Sylja premtion shumë për t;u bërë pjesë e rëndësishme e autorëve që sjellin për lexuesin literaturë islame, aq e mirëpritur kjo nga besimtarët muslimanë Nuk janë të pakët ata që mendojnë se libër i vlerësuar është ai që qarkullon me shpejtësi nga vitrina, ku është vendosur, drej lexuesit, sepse numuri i librave, që e bëjnë këtë rrugim ,është edhe vlerësimi më i saktë i një botimi Mendojmë se libri Fjalë Frymëzuese, e autorit Mirsad Sylja, i ka arritur këto parametra të cilat do t'i dëshëronte t'i arrinte edhe një autor që ka shkruar më shumë se një libër Qarkullimi i sukseshëm i tij tek lexuesi është realizuar edhe falë një tematike të larmishme dhe trajtimit të saj me një thjeshtësi të çuditshme e cila vetëm sa e bën atë edhe më të kapshme nga lexuesi ,pa ia ulur vlerat të cilat janë pjesa më e pranueshme e kësaj tematike Por, të marrësh guximin të prekësh tema të cilat literature islame i ka lakuar përmes pendave më të njohura të saj dhe të jesh i mirëpritur nga lexuesi kur këto tema i shikon të trajtuara nga një maturant medrezis do të thotë se autori , Mirsad Sylja ,e ka fituar betejën e pare me lexuesin musliman i cili nuk e ka të tijën të pranojë një botim për oportunitet . Këtu



mendojmë se duhet kërkuar edhe suksesi i këtij libri .Pa u larguar nga tematka e librit, duhet ta perifranojmë atë që trajton kjo tematikë duke e vendosur piketën e pare tek njohja që besimtari musliman duhet të ketë për

Krijuesin e tij ,se, duke e njohur atë, besimtari musliman do të kuptojë madhësinë e Krijuesit dhe të tjerat që vijnë pas janë vetëm pjesë e arritjeve të cilat do të bëhen pjesa më e rëndësishme e jetës së një muslimani

Autori na përcjell mesazhe islame në botimin e pare të tij të cilat janë shqetësimi i tij shpirtëror sepse ai faktiksh është pjesë e këtij shqetësimi .Prandaj edhe e ngre zërin duke i kujtuar sidomos rinisë slame misionin e saj të vërtetë i cili është kontributi i saj për islamit dhe në këtë kontribut, Mirsad Sylja, shikon rritjen e përkushtimit të të rinjve muslimanë që duhet të ndeshen dhe të fitojnë betejën me armiqtë e islamit të cilët pikërisht rininë islame e kanë piketuar të parën për ta nxerrë islamit nga shinat e tij hyjnore, duke rezervuar shinat e tyre që e drejtojnë Islamit drejt shkatërrimit të tij Duke qëndruar pak i vendosur në hije, autori u kujton besimtarë muslimanë se ato nuk duhet të harrojnë disa nga shtyllat kryesore të islamit si: Namazi, Haxhi ,Zekati të cilat janë kushti kryesor për të kompletuar portretin e një besimtari musliman

Përballë një propogande denigruese për fenë islame, libri Fjalë Frymëzuese sjell fakte se feja islame është fe e përparimit të shkencës duke u shtrirë me arritjet e saj në të gjitha hapësirat ku të gjitha shkencat krenohen për rezultatet e tyre.Duke mbetur gjithmonë në përpjekje për të thellë fjalë të mira dhe inkurajuese ,por gjithmonë të vërteta ,ne i urojmë botimit të ri, Fjalë Frymëzuese, suksese dhe për autorin do të dëshëronim që penda e tij të na dhuronte edhe botime të reja duke pasqyruar se të botosh do të thotë të angazhohesh shumë.Dhe i angazhuari më i vlerësuar ka qenë gjithmonë ai që ne e quajmë krijuesi i letrave të cilët janë portretizuar si ingjinerët e shprtrave. Dhe të jesh ingjiner i shprtrave të muslimanëve është diploma më e mire që një musliman mund të marrë në jetën e tij

Selim Gokaj
Shkodër, me 29 shkurt 2008.

KONFERENCA E VENDEVE ISLAMIKE NË NJË Mbledhje të rradhës

Eshte mbledhur Konferenca e Vendeve Islamike e cila në rendin e saj të ditës ka diskutuar probleme që kanë të bëjnë me sfidat me të cilat po përballlet sot bota islame dhe qëndrimin që duhet të mbajnë muslimanët ndaj këtyre sfidave dhe cilat do të jenë rrugët në të cilat duhet të ecin vendet muslimane në këto momente historike që me sa shihet janë tejet të ngarkuara me përplasje në mes të qytetërimeve, ku të bie në sy penalizimi i botës islame si alibi e atyre që ndjehen tepër ngushtë nga përhapja me shpejtësi i mesazhit islam sot në botë. Konferenca e Vendeve Islamike i zhvilloi punimet e saj me një rend dite ku kërkohet që ky organizëm të ketë një vend përfaqësimi në Këshillin e Sigurimit dhe një vend përfaqësimi në Këshillin e Evropës. Nga ana tjetër në këtë mbledhje u diskutua edhe për çështjen e terrorizmit duke theksuar se terrorizmi nuk është tregues i muslimanëve dhe i fesë islamë Konferenca e Vendeve Islamike e trajtoi si shqetësim të saj çështjen e qëndrimit negativ të Përdimit ndaj Islamit, si dukuri që krijon situata të tensionuara në të gjithë botën.

Një e veçantë e kësaj mbledhjeje ishte kërkesa e Turqisë për të përfshirë në rend të ditës një pikë të veçantë, ku vendet e Konferencës Islamike të njohin në bllok Pavarësinë e Kosovës. Pavarësisht nga qëndrimi që do të mbajnë këto vende në këtë mbledhje, Turqia është e gatshme që pranimin e Pavarësisë së Kosovës nga Konferenca e Vendeve Islamike ta trajtojë edhe në mbledhjen e ministrave të jashtëm të Vendeve të Konferencës Islamike që do të mbahet së shpejti. Ky qëndrim i Turqisë ndaj Pavarësisë së Kosovës tregon se Turqia ka qënë dhe vazhdon të jetë



garanci e mbrojtjes së çështjes shqiptare në Ballkan sepse është historia e shkuar dhe e sotme që i lidh popujt e këtyre dy vendeve

Median më të njohura ndërkombëtare, duke komentuar potencialin njerëzor, ekonomik dhe kulturor të vendeve muslimane theksuan se Konferenca e Vendeve Islamike ka sot një rendësi të veçantë për politikën botërore.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME LULEZIM BASHA NE KONFERENCEN E VENDEVE ISLAMIKE

Në Dakart u zhvillua një samit dy ditor i Konferencës së Vendeve Islamike i cili, në rëndin e tij të ditës kishte çështjen e përballjes së vendeve muslimane sot në botë me një islamofobi të theksuar nga bota perëndimore dhe nga shtete dhe organizma të saj të veçanta. Për here të pare, Shqipëria, pas 10 vitesh, përfaqësohet me një zyrtar të një rangu të lartë, siç është ministri i saj i jashtëm, Lulezim Basha. E veçanta që duhet të theksohet është se, pas gjithë atij qëndrimi të ashpër që ka mbajtur opozita shqiptare dhe segmente të caktuara të magjorancës dhe sidomos penalizimi i jashtzakonshëm i mediave shqiptare për Konferencën e Vendeve Islamike dhe për anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizëm, tashti shteti shqiptar po i rikthen sytë nga aktiviteti i këtij organizmi që ka kaq rendësi për politikën botërore, kur kemi parasysh numurin e madh të popullsisë dhe rezervat kolosale të naftës që posedojnë këto vende. Por, Shqipëria nuk do ta ketë të lehtë të marrë kthesën e duhur dhe të bëhet një anëtare e devotshme e Konferencës së Vendeve Islamike, sepse politika shqiptare, si e theksuam edhe më lart, e ka demonizuar deri në absurditet anëtarë-

simin e Shqipërisë në këtë organizëm dhe ajo që është edhe më e rëndë është se mbi vendet e Konferencës së Vendeve Islamike është hedhur balltë permes shpifjeve, pa harruar se Shqipëria është e angazhuar me trupa ushtarake në Irak dhe Afganistan përkrah shteteve që i kanë pushtuar këto vende. Të mos harrojmë se çdo anëtar i Konferencës së Vendeve Islamike e ka të ndaluar të jetë pjesë e një ushtrie që ka pushtuar një shtet që bën pjesë në këtë organizëm. Mendojmë që ministri i jashtëm shqiptar do ta ketë të vështirë të bëjë një lobiaj të suksesshëm në favor të çështjes së njohjes së Pavarësisë së Kosovës, megjithë mbështetjen e fuqishme të Turqisë për të bindur këtë organizëm që shtetet, që bëjnë pjesë në këtë organizëm, të votojnë në bllok për të njohur Pavarësinë e Kosovës. Nuk duhet të harrojmë se është vertetur pa mëdyshje, që bashkangjitja ndaj politikës së shteteve të mëdha, kurrë nuk ka kaluar pa një kosto të lartë për ato vende që e kanë quajtur të drejtë ndjekjen e një politike të tillë.

PARADOKSE TË POLITIKËS SHQIPTARE NË BALLKAN

Në një emision të transmetuar permes TV ALSAT, teleshikuesi pati rastin të njihet me jetën dhe problemet e një pakice etnike boshnjake që jeton në Shqipëri që në vitet 1930. Ajo që na bëri përshtypje ishte deklarata e njërit nga përfaqësuesit e komunitetit boshnjak i cili tha se lëvizjen e tyre drejt vendlindjes, Bosnjes, e vështirëson vonesa e dhënies së viza nga përfaqësitë përkatëse shtetërore të ngarkuara për të kryer këtë regjim vizash. Ajo që na shqetësoi dhe na tronditi ishte pjesa tjetër e deklaratës së të intervistuarit boshnjak, i cili tha se për Malin e Zi dhe për Serbinë shteti shqiptar i ka hequr vizat dhe ata mund të lëvizin të lire në Shqipëri si në shtetpëtë e tyre. Kurse, për të shkuar në Bosnje nga Shqipëria, duhet të marrësh viza shqiptare. E quajtmë paradoks këtë vepër të qeverisë shqiptare, por dhe aq paradoks nuk duhet të jetë, sepse është po kjo qeveri demokratike e cila nuk i pranoi refugjatët e mjerë boshnjakë, që po përjetonin një genocid edhe më të ashpër se ai që u bë kundër çifutëve në LDB nga armata serbe që, po të kishte në dispozicion krematoriumet e nazistëve, do t'i përdorte pa hezitim kundër muslimanëve të Bosnjes. Duket se politika shqiptare, me tutor faktorin ndërkombëtar, vijigjëlton dhe vepron që popuj muslimanë t'i mbajë sa më larg Shqipërisë, sepse duket qe frikësohet nga "Një

infektim i mundshëm i një islami radikal" që mund t'u prishë planet atyre që po bëjnë përpjekje për ta amortizuar përkushtimin e muslimanëve shqiptarë në emër të një "Islami të moderuar", alias të një islami që nuk e ka problem të ulë kurrizin përballë sfidave me të cilat po përballohen sot muslimanët në Shqipëri dhe më gjërë.

Për qeverinë demokratike, serbe dhe malazeze le t'i bien kryq e tërthorë Shqipërisë në emër të një fqinjësie të mire, si shpërblim për "Të mirat" që i kanë bërë shqiptarve. Vetëm muslimanët e Bosnjes duhet të sorollatën nëpër zyra nëpunësish që të marrin një vizë, që herën e dytë të mendohen mire para se të ndërmarrin një iniciativë, për të kërkuar një vizë për të shkuar në Bosnje. Dhe mos të harrojmë se është kjo qeveri shqiptare që po kërkon me këmbëngulje nga BE, që për shqiptarët të hiqet regjimi i vizave në mënyrë që ata të lëvizin të lire drejt Evropës. Besojmë se qeveria shqiptare duhet të distancohet sa më shpejt nga ky paradoks, duke e hequr regjimin e vizave edhe për boshnjakët për hequr kështu dorë nga diskriminimi i tyre dhe duke i trajtuar muslimanët boshnjakë me të njëjtat parametra si serbet, maqedonasit dhe malazezët.

Përgatiti Alban Kastrati

SHEKULLI I NJEZETE ME TURP KA PERFUNDUE

Shekulli i njëzetë me turp ka përfunduar
Në tryezën e Evropës nga serbi afru
Të gjitha gjitha krimet e poshtërsitë u bane
Se boshnjakët e kosovarët muslimanë janë.
Mësimet e historiesë kurr s'duhen harru
Me ndërgegjeje e kujdes duhen kujtu.
Shekuj me rrallë muslimanët sunduen
Nën ombrellën e tyre të gjithë lulëzuen.
Kur Evropa jahudijtë s'i deshi
Nen hijen e Sulltanit fati u qeshi
Në muzeun e Sulltan Ahmetit
Shpaloset letra e Sulltan Mehmetit
Që bota mbarë qartë ta shohin
Madhështinë e Islamit duhet ta njohin
Lexo letrën që Mehmet el Fatih shkroi
Kryepeshkopit kristian n; Bosnje ia çoi
Të drejtat tuaja gjithmonë do t'mbrohen
Prej askujt s'lejohen të cënohen
Kjo është drejtësia që Allahudhuroi
Bogomili i Bosnjës Islamin përqafoi
Begati të e Allahut lëmoshë nuk janë
Nga mëshira e tij gjithësisë i dha
Por serbi dhe të tjerë kurr s'i pranun
Me smirën e tyre gjithmonë i mohun
Mlllef e urrejtje të mbushur gjithmon
Egërsia e tyreqartë i kallxon
Plane e intriga me urrejtje përpilun
Me urrejtjen e tyre n'jetë i vunë
Me dhunën e tyre muslimanët shtërngun
Me force n' themel ata i sulmun
Krimet etyre me kryq e bibël n' dor
Barbarizmi vrasja për ta kurorë
Vajzën n'sy nanës përdhunun
Nga tmerri i tyre gjithësia u tund
Atë foshnjë që dikur n' prehër e mbante
Përdhunimin e saj me dënësë tani qante
Të gjitha këto n; oborr t' qutetërimit
N'Evropën dinake sherri imkrimit
Gjërat e bukura serbt i shkatërrun
Jetën dhe nderin si bishat ata përdhunun
Rëkimet britmat për ata muzikë
Se krimi i tyre çdo ndjenjë fikë
Londër Paris Romë Vjenë Berlin
Politikani evropjan ...tue zgërdhi rrin
Nën thundrën e serbit nderi rënkonte
Pa asnjë pike turpi krimi vazhdonte
I madh dhe i vogël nga ata krimin n'jetë vu

E gjithë kjo llahtari nga popi beku
Kodra, male fusha tokë e qiell
Prej krimeve t' shkajut turpnu e dridh.
Danubi ,Siena Rajn ...me ujën që kanë
Krimet e serbeve kurr s' mund t'i lajn
Rënkimet , thirrjet pa ndigjue nuk shkojn
Allahu i ndigjon mizorit mos t' harrojm
Dënimi i tyre nga Allahu vet
Pa dyshin n' xhehmem për jetë
N' kampe çnderi muslimanet grumbullun
Me kriminelë dhe trogum ata i përdhunun
Kriminelët serbë i linin shtatzanë
Që kopili serb t.i kishta ata nanë
Donin t' vrisnin gjithmonë shpresën
Ushitari i Evropës e shkeli besën
Ushitari hollandes e t'jerë si ata
Dëshmun, por krimet rrugë i la.
Për Srebrenicën sot apelojnë
Por për viktimat gjithmonë harrojnë
Kur serb menduen se boshnjakët i thyen
Me barbarizëm kosovarën mësyen.
Shkatërrime pastrim etnik
Kulturës e qytetërimin n' shpin n' thik.
Pastrime etnike shoqëruar me llahtari
Krimet e serbeve damkë në histori.
Inkuzicioni serb si shum kund zanat
Si n' Palestin Indi e dikur n' Granat
Mos t'lihet n'harres populli i Çeçenisë
Që digjet e piqet nga shqjtë e Rusisë
Më kryq n'dorë krimet u bane
Por askush s'u tha terrorista kristianë
Karaxhiç, Mlladiç si cuba shetisin
N' Serbi kriminelët t'liërë livadhisin.
Vllazën krimet serbe fëmijve u tregoni
Që masakrat kurr mos harroni
Vrasjet dhe krimet serbët i bane
Se boshnjakë e kasovarë muslimanë janë
Ashtu ata janë e ashtu do të jenë
Per Fenë e Atdhe Allahut i kanë ba benë.
Evropa dhe bata mbarë ta kuptojnë
Se dritën e Allahut s'mund ta ndalojnë
Asht e udhës për qytetërimin
Dora e bashkëpunimit t'i zgjatet njerëzimit.

Houston , Teksas: 2007
Burhan Al Din Fili



KOSOVA E PAVARUR

Madhnu qofsh, o i Madhi Zot
Që Kosovën ke nderue
E Pavarur ajo është sot
Kusht' ndihmoj...s' ka m'u harru.

Rrofsh e qofsh Kosova jonë
Me popullin tën që ti ke
E pavdekshme je gjithmonë
Për ty vdesim si me le.

Me qumsht dashurie ti u rrite
Faqebardhë gjithmon t'jesh
Me zemër e shpirt yll drite
Fat t' mbar gjithmon t' kesh

Djem e vajza jepni vehtes
N'qiellt; lirisë fluturoni
Jepni udhë si duhet jetës
Kosovën Loke gjithmonë nderoni.

Shumë gjak asht derdh
Shumë shpirtra jan flijju
Që dritë lirie me ju sjell
Allahu vetë ka m'i nderu.

O shqiptarë kudo që jeni
Krahët tuaj sot bashkoni
Amanetin mos e leni
Trojet tona t'i ndihmoni

Houston , Teksas: 2007
Burhan Al Din Fili

DIVERSION FETAR

NEPER SHTEPITE E MUSLIMANEVE NE SHKODER

Në Shkodër, po merr të drejtën e qytetarisë një fenomen i shëmtuar që ka të bëjë me një trokitje ogurzeze nëpër shtëpitë e muslimanëve nga disa persona .që zakonisht janë femra, të cilat, me disa broshura nëpër duar, i shqetësojnë besimtarët muslimanë duke u përpjekur tua mbushin mendjen me disa teori, sipas të cilave ,ata duhet të lëvizin nga pozicioni i tyre fetar musliman për të gjetë një strehë të re fetare, në emër të një zoti të ri të cilit duket se i luten ata që po trokasin në dyert e muslimanëve nëpër Shkodër për të bërë diversion në emër edhe të një propogandë të lire fetare që u garanton koha që ne e quajmë demokracia perëndimore. Ajo që të shqetëson shumë është një këmbëngulje e ashpër që përdorin misionarët në kontaktet e tyre ,si miq të paftuar, me muslimanët në Shkodër.Po t'i vësh re, këta ambulantë fetarë të dyshimtë, ata kanë pamjen e një rrëzve që sapo kanë dale nga qendrat e tyre të instruksionit, ku kanë marrë udhëzime që, në misionin e tyre diversionist kundër muslimanëve, të përdorin kulacën dhe kërbacën. Së pari, ata përpiqen të bëjnë teori fetare për të mashtruar bashkëbiseduesin dhe pastaj ,kur e shohin se kanë rezistencë, e çojnë zërin dhe të afrohen aq pranë, sa mund të ndiesh edhe frymëmarrjen e tyre të shqetësuar Duket se këto misionarë kanë marrë udhëzime përt'ua mbushur mendjen muslimanëve se ata kanë një fe që nuk u plotëson nevojat e tyre shpirtërore dhe shpëtim për muslimanët është Jehovahi , Bahai, Protestanizmi dhe sa izma të tjera që në Shkodër dhe në hapësirat shqiptare po vërshojnë, sikur të ishin duke operuar nëpër pyjet e Amazonës, ku jetojnë njerëz që janë pa ngarkesa fetare dhe që duhen shpëtuar me frymën e zotit .Por, duke operuar në hapësirat shqiptare, ku pa tjetër e rendësishe për këto misionarë dhe për qendrat e tyre është edhe Shkodra, ata duket se harrojnë, ose bëjnë sikur harrojnë,

që këtu njerëzit nuk kanë boshllëk fetar, por janë të angazhuar fetarisht në tri fe për të cilat .propoganda fetare në mediat e huaja dhe ato vendase, këmbëngul se jetojnë në një harmoni fetare, duke pasë për ketë problem edhe një mbështetje mediatike shtetërore që ajo këmbëngul se tri fetë në Shqipëri bashkëjetojnë . Duket se këto misionarë fetarë dhe prapavja e tyre fetare kanë si mision pikërisht të prishin këtë harmoni fetare, sepse besimtarët e rinj të këtyre feve, që po ngrejnë krye si kërmijtë pas shiut, duket se nuk janë të gatshëm për bashkëegzistencë ,por janë të gatshëm për të rritur kontigjentin e tyre, duke boshatisur hapësirat muslimane nga besimtarët muslimanë. Institucionet fetare islame në Shqipëri ,duke filluar nga qendra dhe duke u ulur në rrethe ,duhet të bëjnë një propogandë të hapur dhe pa frikë në rrallët e muslimanëve dhe në hapësirat mediatike, për të demaskuar metodat e rrezikshme dhe mashtruese që po bëjnë misionarët perëndimorë nëpër shtëpitë e muslimanëve në Shqipëri. Por, edhe për vetë muslimanët ,ka ardhë koha që t'u japin një përgjigje të merituar këtyre kasneocëve që, për një page mbijetese, hapin pa leje dyert e familjeve muslimane nëpër qytetet shqiptare . Ne patëm rastin të debatohim me dy misionare të Bahajve që kishin ardhë nga Berati i largët për të na thenë se ju muslimanët keni nevojë për reformim fetar për të shpëtuar në botën tjetër . Mendojmë se ky investim i fuqishëm ,që lëviz këto mijra misionarë dhe ka ngritur në këmbë këto qindra qendra që drejtojnë këto misionarë ,janë pjesë e strategjisë globale që, vazhduesit e kryqzata të dikurshme,përpiqen të realizojnë sot kundër botës Islame, pjesë e së cilës janë edhe muslimanët shqiptarë

Andi Kraja



**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**



- 1- Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692101893

**EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT**

ILIRIA

me pronar Haxh Ilir Muja (aktivist dhe bamirës Islam), ju afrojmë prodhime nga me" të thjeshtat deri në dhoma gjumi. Shërbehet në kohë dhe me cilësi të lartë:

- Prodhim dyer e dritare**
- Dhoma gjumi**
- Pajisje zyrash**
- Pajisje kuzhine**
- Dhoma fëmijësh**

Pajisje për ambiente lokale
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tonë dhe do të mbeteni të kënaqur. Mund të kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

